

SHABAN QESARAKU

JUSTIN RROTA, PROMOVUES I TEKSTEVE TË VJETRA SHQIPE

Studimet e At Justin Rrotës për tekstet e vjetra shqipe, për ndriçimin e thesareve të paçmueshme të kulturës shqiptare, e sidomos të gjuhës së më të vjetrit autor shqiptar, Gjon Buzukut me veprën e tij “Meshari”, të cilën arriti ta sjellë kopje në Shqipëri, përbëjnë një ndër ato arritje kulturore të veçanta në llojin e vet jo vetëm për karakterin shkencor, por dhe për admirimin e veçantë të punës me plot pasion të tij.

E parë me sytë e së sotmes, ndërmarrja e studimeve të këtij lloji nga brezi ynë, ndoshta do të ishte një mision i pamundur për vetë faktin, se njeriut të kohës sonë duket se nuk i mbetet kohë për trajtime të tilla për t’u marrë me trashëgiminë kulturore të të parëve tanë, por dhe për kushtet e krijuara, të cilat favorizojnë ose jo, nisjen e një pune të tillë. Pasuria e dhuruar nga Justin Rrota parë vetëm nga ky këndvështrim është e pazëvendësueshme.

Justin Rrota me studimin për “Mesharin” si veprën e parë të dokumentuar në gjuhën shqipe, hap rrugën për njohjen e trashëgimisë së popullit tonë të një periudhe aq të ngjeshur me ngjarje historike si rrallëherë.

“Meshari” i Gjon Buzukut i botuar më 1555 është dëshmia e parë e njohur deri më sot e pakontestueshme që vërteton se si është folur gjuha shqipe në shekullin XV. “*Të ndiejmë shqipen, si kje folun në shekullin ngjitë mbas deke të Skënderbeut*”¹.

Në dhënien e vlerësimit tonë për prurjen e bërë nga Justin Rrota do të përqendrohemi kryesisht te studimi i tij për veprën “Meshari”, pa harruar kontributin edhe në studimet e tjera, duke u munduar të alternojmë trajtesat e ndryshme që lidhen sa me punën që autori ka bërë në paraqitjen shkencore të studimit të tij, aq dhe me ndjesitë e përjetuara nga vetë ai për hulumtimet e bëra.

Një ndërmarrje për një punë të rëndësishme siç ishte ajo e zbulimit të veprës së parë shqipe, që J. Rrota do ta quante *Monumenti ma i vjetër i gjuhës shqipe*, nuk mund të realizohej pa dashurinë me të cilën duhet ta kryesh një punë të përmasave të tilla. Në vetë shkrimet e tij vërejmë pasionin e veçantë të klerikut të përkushtuar me një vullnet të paepur, atdhetarin me një ndjeshmëri të veçantë, studiuesin këmbëngulës, mësuesin e dashur, njeriun e thjeshtë. Ai i vuri vetes një qëllim, një mision dhe ia arriti: të sillte në tokën shqiptare *mbassi s’ ishte e mundun kopjen originale, që njihet e vetmja ndër botë, - ndëmore librin e fotografuëm*...² Është ndër rastet e rralla përputhja mes formimit intelektual të një

¹ J. Rrota, *Për historin e alfabetit shqip*, 2005, Monumenti ma i vjetër i gjuhës shqipe, faqe 3.

² J. Rrota, *Për historin e alfabetit shqip*, 2005, Ma të parat kopje të fotografueme të Buzukut ndër Shqipëri

personi dhe dëshira për të realizuar një punë që përkon me këtë formim. Rrethanat dukej se punonin për këtë. Duke qenë se ai i përkiste urdhrin të françeskanëve ishte një mundësi më tepër për t'u lejuar të vinte në Romë dhe të punonte me leje të posaçme në bibliotekë. Nga ana tjetër njohja e gjuhëve klasike dhe moderne përbënin përsëri një përparësi për punën e tij në shumë drejtime. Nga ajo që informohemi në lidhje me ndërmarrjen e tij fisnike, të cilën ai gjen rast ta përmendë të shoqëruar gjithmonë me shqetësimin e tij për mbarëvajtjen e punës, duket në pamje të parë sikur fati është me të. Ndoshta po, por duke qenë një fetar i përkushtuar, zoti ia lehtësoi punën besimtarit të përlulur të tij, duke ia shpërblyer në formën më të mirë të mundshme. Gjithashtu nuk mund të anashkaloj faktin se ai ka qenë personi ndoshta më i angazhuari, më i shqetësuar për këtë betejë të madhe në fushën e dijes.

Përkushtimi ndaj një pune të tillë do të shprehet shpesh nga ai me një modesti që mund të duket e tepruar, por e shpjegueshme, kur kemi parasysh këndvështrimin me të cilën e shikonte atë që ai e quante *visar buzukjan*. "... *jo si ma kompetenti, por se di tashti pse u dftova aq entuziast qeshë zgjedhë vetë për këtë mission...*"³. Kjo vlerë e modestisë së tij do të përshkojë edhe pjesën e studimit, kur vetë ai shprehet *që lë të hapur shtegun që të gjithë intelektualët kanë të drejtën për të bërë ndërhyrjet e veta, me qëllim që ta shndrisin veprën*⁴.

Shpeshherë tek vetë Rrota do të jetë e pranishme dhe ngritja e zërit të tij, një lloj revolte (sa mund të revoltohet një njeri që përçon fjalën e zotit) ndaj heshtjes së intelektualëve. Një shqetësim qytetar dhe atdhetar i një personi jo të zakonshëm. Përmendim dy momente: I pari ishte rasti për ndërgjegjësimin e masës së intelektualëve, qëndrimi i tyre në heshtje, indiferentë ndaj një ngjarjeje që kishin botuar revistat e kohës për ekzistencën e një kopjeje *të librit ma të vjetrit shqip*⁵. Rasti i dytë ishte puna këmbëngulëse për të bindur ata që e kishin në dorë mbarëvajtjen e punës për gjetjen e librit në fjalë, *ta kuptojshin rëndësinë e dokumentit e ta shndërronin në realitet dëshirën e vullnetmirëve*.⁶

Studimi shkencor i J. Rrotës mbi historinë e zbulimit të veprës "Meshari" është i ndërtuar mbi dy shtylla, ose pjesë kryesore. Në pjesën e parë autori është marrë me gjenezën e veprës së Gjon Buzukut dhe në pjesën e dytë me lëndën e saj. Këto ndarje kryesore i shoqëron më pas me nënndarje të tjera, që theksojnë çështje të shumta të planeve të veprës. Në analizën e bërë për secilën pjesë apo nënndarje vërejmë qartësinë me të cilën i rendit ngjarjet. Duke i parë në një plan krahasues autori bën në këtë mënyrë analizën e saj. Është pikërisht ky fakt, i cili ka bërë të mundur që të kuptohet më mirë çështja e krijimit të veprës, por dhe niveli i përfaqësimit të saj, siç është qëllimi, apo përmbajtja e saj.

Në pjesën e parë, atë të historisë së librit jepet rruga e mundimshme përmes së cilës ka kaluar kjo vepër për të mbërritur deri në daljen në dritë të saj. Të bie në sy

³ J. Rrota, *Për historinë e alfabetit shqip*, 2005 Monumenti ma i vjetër i gjuhës shqipe, f. 57.

⁴ Po aty, f. 57.

⁵ Po aty, f. 57.

⁶ Po aty, f. 57.

vlerësimi për detajet, si ato që gjenden në vetë veprën edhe ato që lidhen me historinë e gjetjes së saj. Mjafton të përmendim paraqitjen e jashtme të librit, shënimet e bëra në kohë të ndryshme nga persona të ndryshëm (klerikë që e përdornin atë), mungesa e disa faqeve dhe e parathënies, lloji i shkrimit, fillimi i frazës etj., të gjitha këto në funksion të qëllimit, atë të ndriçimit të saj.

Pjesa e dytë e studimit të Mesharit ka fokus kryesor trajtimin gjuhësor të saj. Duke qenë mësues i gjuhës shqipe⁷ dhe studiues i saj, njohës i gjuhëve klasike dhe atyre kryesore evropiane, ai me trajtimin gjuhësor që i bën veprës tregon përgatitjen e admiruar filologjike që zotëron.

Autori në shkrime të tjera të mëvonshme, gjithmonë duke mos iu ndarë dashurisë së tij për shkrimet e vjetra, do t'i rikthehet trajtimit të pjesëve të veçanta, të cilat i ka prekur te "Meshari" më parë, për t'i dhënë ato në një kuadër më të plotë. Dua të theksoj faktin se me daljen në dritë të kësaj vepre, Justin Rrota krijoi mundësinë të studiuesit e tjerë që t'i referohen dhe të studiojnë më në thellësi problematikën e veçantë që paraqet vepra. Nuk e teproj nëse them se me intuitën e një shkencëtari ai bëri gjetje të duhura, në vetë tekstin, në pjesë të caktuara të tij, të cilat do të shërbenin më pas si fusha studimi për gjuhëtarët kryesisht. Studimet e tij kulmuan me gjurmimet në fushën e tekstologjisë, transkribimit dhe interpretimit filologjik të teksteve. Ai gjeti vend për të ngritur probleme të rëndësishme rreth autorit të veprës dhe vetë veprës, të cilat janë bërë objekt trajtimesh me zgjidhje nga më të ndryshmet. Kujtojmë se paraqitja për herë të parë në një formë filologjike e kolofonit nga J. Rrota është vlerë e veçantë, jo vetëm për faktin se kolofoni mbart në vetvete informacionin në lidhje me punën e mundimshme të krijuesit të tij, por dhe për atë që studiuesit i janë referuar shpesh atij në të ardhmen. Bazuar mbi një kontribut të tillë do të mbështetej dhe Eqrem Çabej, i cili do t'i bënte pjesës (kolofonit) transkriptimin, një punë që kërkon njohjen shkencore dhe këmbënguljen e veçantë, si dhe do të vlerësonte Rrotën për kontributin e dhënë në afirmimin e kësaj vepre. Sipas Çabejt, Rrota "ka ndihmuar shumë ndër ne në përhapjen dhe në njohjen e këtij monumenti gjuhësor".

Studiuesi Injac Zamputi, duke u mbështetur te evidentimi që J. Rrota bën për atë që librit i mungojnë fletët e para, arrin të nxjerrë konkluzione të besueshme. Vetë ky autor në studimin "Mbi rrethanat historike të botimit të "Mesharit" të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare" shkruan se "duhet t'u jemi mirënjohës atyre personave që e patën në dorë ekzemplarën e Mesharit që na ka tepruar dhe nuk ia grisën të gjitha fletët (...) sikur të mos i ishin grisur fletët e para, ku ishte edhe frontespici, (...) Meshari ynë do të ishte zhdukur tërësisht. Pa atë frontespici, i ka shpëtuar syrit të inkuizitorit dhe bibliotekari nuk ka patur frikë ta mbante"⁸

Në konceptimin e ndërtimit të studimit të tij, një vend të rëndësishëm zë përzgjedhja e qëllimit të disa pjesëve tregimtare të shkëputura nga "Meshari". Me

⁷ www.proletari.com/forumi/viewtopic.php?f=52&t (Më 1917 hapi në Plan të Dukagjinit shkollën e parë shqipe).

⁸ Revista "Studime filologjike", nr. 3, 1986, f. 194.

dëshirën e mirë që ky autor ka për lexuesit shqiptarë kërkon që këto pjesë të përzgjedhura nga ana e tij të jenë të lexueshme e të kuptueshme nga të gjithë. Puna e tij në këtë drejtim përqendrohet në dhënien e formës origjinale dhe të përshtatur në gjuhën e kohës, shoqëruar dhe me shpjegimet përkatëse. Funkcionaliteti i pjesëve të përzgjedhura ka të bëjë gjithashtu dhe me faktin për t'u trajtuar në tekstet shkollore. Mendoj se trajtimi i këtyre pjesëve në këtë këndvështrim nuk është i rastësishëm, por i menduar mirë. Justin Rrota përveç se studiues, siç jemi shprehur dhe më lart është dhe mësues. Njohës i gjuhëve moderne, duke qenë njëkohësisht dhe studiues i tyre, ai përfitoi prej tyre shtjellimin metodik e në këtë kuptim trajtimi i këtyre pjesëve ka lidhje me formimin e tij shkencor. Një autor, siç është Buzuku do të mbahet mend nga njerëzit, kur është i lexuar nga ata, e sidomos nga nxënësit, të cilët e kanë pjesë të programit shkollor tekstin tregimtar të autorit.

Vetë vepra “Meshari” e Gjon Buzukut, ka në vetvete një kontekst vijimësie, një lidhje unike që është funksionale, jo vetëm në realizimin e qëllimit të saj por dhe në vetë pjesët përbërëse, pavarësisht se në vetvete ato janë të ndryshme. Po ta shohim në një raport më të gjerë gjithë krijimtarinë e Justin Rrotës, ajo do të vazhdojë ta ketë këtë vijimësi. Ai nuk do të shkëputet nga trajtimi i temave në fushën e parapëlqyer të tij, atë të nxjerrjes së vlerave historike e gjuhësore të krijimtarisë së autorëve të periudhës së mesjetës dhe në mënyrë të veçantë të studimit të historikut të gjuhës shqipe. Gjithmonë, pas çdo studimi të ri, apo rimarrje të çështjeve të trajtuara rishtas ai realizon prurje të reja, të veçanta në llojin e vet.

Shpeshherë në shkrimet e tij, sidomos ato që lidheshin me zbulimin e “Mesharit”, Justin Rrota do të shkruante për përgjegjësinë e punës që kish marrë përsipër. Gjithmonë ishte i shqetësuar për këtë gjë. I dukej se mosrealizimi i kësaj pune varej nga ai vetë. Përmendja e këtij shqetësimi nuk ka qenë qëllim në vetvete nga ana e Justin Rrotës, por një përkushtim i një njeriu, vlerat e të cilit janë të kontributi në këtë lëmë të dijes. “...barra m'e zhvorrue Buzukun, erdh e m'u pështjellue aqë, sa, për një ças u pendova, pse ia kishem hy ndopak”⁹. Momentet e gëzimit gjithashtu janë pjesë e shqetësimit të tij. Lajmi i marrë për personin që kish dijeni për “Mesharin” jepet me notat më të larta të entuziazmit që i kalon kufijtë e studiuesit serioz. “Të më kishite thanë, se, m'ishite ngjalle prej vorrit njëni robësh së mi te dekunë, nuk e dij, se do t'ishem gezue ma fort. Sa s'kjeshë tue i ra ndë gjuhë përpara, me i puthun kambën. Kaq!”¹⁰

Gjatë gjithë jetës së tij shqetësimi për punën, kryerjen e një vlere të dobishme do të ishte i pranishëm te vepra e tij. Edhe në kushtet e pamundësisë fizike (në vitin 1925 fillon t'i përparojë sëmundja e paralizës), ai nuk e ndërpreu për asnjë çast punën e tij kërkimore, madje e shtoi atë, duke vazhduar deri në fund të jetës së tij.

⁹ J. Rrota, *Për historin e alfabetit shqip*, 2005 Monumenti ma i vjetër i gjuhës shqipe, f. 57.

¹⁰ Po aty.

Në analizën e mësipërme për çështje të caktuara kemi bërë shpesh dhe vlerësimin si për këto çështje dhe për vetë vlerat e veprës. Në një kuptim më të gjerë, është e rëndësishme që përmbledhtas të theksojmë disa prej tyre.

Vetë ardhja e kopjeve të “Mesharit” përbën një moment historik të veçantë për gjuhën shqipe. “Meshari” në mënyrën e konceptimit të tij nga Justin Rrota na jepet si e para vepër e plotë që shënon fillimin e traditës shkrimore të shqipes dhe të historisë së letërsisë të shkruar shqipe. Kjo vepër, si bartëse e rrethanave shoqërore dhe kulturore të kohës, përfaqëson një nivel interesimi e interpretimi, ku analizat dhe zgjidhjet janë çështje të mëdha që dalin para studiuesit. Justin Rrota bëri të mundur që përmes kësaj veprë, por edhe veprave të tjera të hapë studimet shkencore mbi historinë e dokumenteve të vjetra shqipe dhe të shkrimit shqip.

Është kontribut i shpirtit dhe ndjeshmërisë së At Justin Rrotës përballë librit të parë të shkruar shqip, një punë që kishte një parahistori kërkimi e zbulimi, por atij i takoi fati që në një farë mënyre e kërkoi më shumë se të tjerët, të shkonte në Romë, ta gjente e sillte në Shqipëri.

Së fundi, duke perifrastuar Fishtën, - njerëz të tillë i lanë një përmendore vetes me veprat e tyre përkushtim Atdhetarie, çka i ban të pavdekshëm.

BIBLIOGRAFI

- E. Çabej, *Gjon Buzuku dhe gjuha e tij*, Nëndori, 1955, n. 3.
E. Çabej, *Studime gjuhësore VI*, Prishtinë, 1977.
E. Çabej, *Shqipja në kapërcyell/Epoka dhe gjuha e Gjon Buzukut*, botime Çabej, Tiranë, 2006.
E. Çabej, *Tekstet e vjetra shqip dhe disa kritere rreth botimit të tyre*, në BUSHT. nr. 2, 1959.
E. Çabej, *Vepra e Gjon Buzukut në vështrim gjuhësor historik*, SF, nr. 1, 1979.
E. Paci, *Çështje të sistemit mbiemëror në “Mesharin” e Gjon Buzukut (mbiemri i panyjshëm)*, *Hylli i Dritës*, nr. 1, 2010.
E. Paci, *Mbi disa përdorime rasore të emrit në veprën “Meshari” të Gjon Buzukut*, në *Gjurmime Albanologjike*, 38, 2008, Prishtinë, 2009.
E. Paci, *Për një vështrim tekstologjik të “Mesharit” të Gjon Buzukut*, në *Hylli i Dritës*, nr. 3, 2011.
E. Paci, *Sistemi mbiemëror në “Mesharin” e Gjon Buzukut*, *Botimet Albanologjike*, Tiranë, 2011.
F. Fishta, *Randësia e librave të Buzukut e të Budit*, *Shkëndija*, Tiranë, 1942, nr. 9-10. *Hylli i Dritës*, Shkodër, nr. 1, 1930.
I. Zamputi, *Mbi rrethanat historike të botimit të “Mesharit” të Gjon Buzukut dhe vendin e tij në letërsinë e vjetër shqiptare*, SF, nr. 3, 1986.
J. Rrota, *Për historinë e alfabetit shqyp dhe studime tjera gjuhësore*, Botime françeskanë, Shkodër, 2005.
L. Marlekaj, *Doli libri më i vjetri i gjuhës shqipe*, *Shëjzat*, nr. 1-2, 1959.
N. Resuli, *Shkrimtarët shqiptarë, I, (nga Buzuku tek arbëreshët e Greqisë)*, Botime Pakti, Tiranë, 2007.
S. Mansaku, *Disa veçori morfosintaksore të librit të parë në gjuhën shqipe*, SF, nr. 1-2, 2001; në *Buzuku dhe gjuha e tij*, Tiranë, 2005.
S. Riza, *Pesë autorët më të vjetër në gjuhën shqipe*, Toena, Tiranë, 2002.

